

#2 INFOGRAFIK

për diskriminimin në bazë gjinore në vendin e punës gjatë periudhës prill - korrik 2020



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Bashkëfinancuar nga
Agjencia Suedeze për
Bashkëpunim Ndërkombëtar



Sweden
Sverige



A E DI SE:

në sektorët që do të pësojnë humbjet më të mëdha nga kriza e shkaktuar nga virusi Kovid - 19, punojnë 43.8 % femra, kurse 34.8 % meshkuj?



një nga sektorët më të rrezikuar është industria e përpunimit e cila përfshin industrinë e tekstilit dhe të lëkurës, ku 80% e të punësuarve janë femra?



30% e femrave kundrejt 16% të meshkujve punojnë në industri që janë "thelbësore" gjatë krizës si: supermarkete dhe dyqane, banka, prodhim të produkteve farmaceutike, mjeke, infermiere, e të ngjashme dhe me këtë i ekspozohen rrezikut shtesë nga infektimi me virusin Kovid-19?



masën për lirim të njërit prej prindërve të fëmijëve deri në 10 vjeç, në pjesën më të madhe e shfrytëzojnë nënat që përballen me paga të reduktuara ose të papaguara¹?

¹ Të dhënat janë marrë nga botimi i Reaktor - hulumtim në aksionin „Puna e paguar dhe e papaguar, diskriminimi i bazuar në gjini dhe të drejtat e punës në kohën e Kovid-19” dhe mund t’i gjeni në www.reaktor.org.mk

NË PERIUDHËN RAPORTUESE, KOMITETI I HELSINKIT:



10

regjistroi 10 raste të diskriminimit ndaj punonjëseve femra në bazë të seksit, gjinisë dhe statusit personal;

11

siguroi ndihmë juridike falas për 11 punonjëse femra, në lidhje me: zgjatjen e kontratës për punësim me kohë të caktuar për punonjëset shtatzëna, ndalimin që punonjëset shtatzëna të punojnë jashtë orarit dhe punë gjatë natës, ngacmimet seksuale në vendin e punës dhe shkeljen e masave qeveritare në lidhje me lirim nga detyrimet e punës për punonjëset shtatzëna dhe nënat e fëmijëve deri në moshën 10 vjeçare;

1

inicoi procedurë gjyqësore për vërtetimin e diskriminimit në bazë të gjinisë në vendin e punës.

3

inicoi tri procedura para Inspektoratit shtetëror të punës për zvogëlimin e paligjshëm dhe mospagesën e pagave për punonjëset që janë nëna të fëmijëve deri në moshën 10 vjeçare dhe janë të liruara nga detyrimet e punës.

+

Procedurat e filluara ende vazhdojnë.

/

Për dy raste të diskriminimit të bazuar në gjini, të inicuar më herët para Inspektoratit shtetëror të punës, marrëmbajtja se punëdhënësit nuk punojnë dhe Inspektorati nuk është në mundësi të kryejë inspektim të jashtëzakonshëm.

RAST:



Komiteti i Helsinkit në qershor regjistroi një rast të diskriminimit ndaj një punonjëseje në bazë të seksit dhe gjinisë. Punonjësja e cila është e punësuar në industrinë e tekstilit na informoi se si nënë e fëmijëve deri në 10 vjeç është e liruar nga detyrimet e punës, por pas kësaj, paga e saj për muajt prill dhe maj u ul në mënyrë të paligjshme dhe arrinte në vetëm 50% të pagës së plotë.

Të punësuarit në industrinë e tekstilit janë kryesisht punonjëse femra, pagat e të cilave nuk janë më të larta se paga minimale. Kështu, disa nga punonjëset - nëna të fëmijëve deri në 10 vjeç, në këtë industri, përderisa janë të liruara nga detyrimet e punës gjatë gjendjes së krizës, marrin një pagë në vlerë prej rreth 7,500.00 denarësh.

Kjo situatë e vë këtë kategori të punonjëseve në një pozitë të pabarabartë përballë punonjësve meshkuj. Kjo është kështu, duke pasur parasysh që ato si femra mbajnë barrën më të madhe të përmbushjes së obligimeve brenda shtëpisë dhe kujdesit për fëmijë, dhe për këtë arsye edhe e shfrytëzojnë këtë masë qeveritare që rezulton edhe me uljen e paligjshme të pagave të tyre, deri në një shumë që nuk mjafton për të përmbushur as nevojat themelore ekzistenciale të njëfamiljeje.



Raporto diskriminimin në bazë gjinore në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, në telefonat **02 / 3119-073** dhe **072 278-436** ose në adresën elektronike **helkom@mhc.org.mk**

Ky infografik u botua me ndihmë financiare të Bashkimit Evropian dhe bashkëfinancim nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmajtja e infografikut është përgjegjësi vetëm e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian ose SIDA-s.